



# E DREJTA PËR QASJE NË GJYKATË



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Përmbledhje tematike e  
praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Kushtetuese



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

## **Përmbledhje tematike e praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese**

### **E DREJTA PËR QASJE NË GJYKATË**

Kjo përmbledhje tematike është hartuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Të gjitha të drejtat autoriale i përkasin Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Përmbledhja tematike do të përditësohet në baza të rregullta nga Gjykata Kushtetuese dhe mund t'i nënshtrohet ndryshimeve redaksionale.

© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, 2024.

## PËRMBAJTJA

Parathënie .....	4
I. E drejta për qasje në gjykatë – <i>Parimet e përgjithshme</i> .....	5
1. Kufizimet që ndërlidhen me afatet kohore .....	6
2. Kufizimet <i>ratione valoris</i> në të drejtën për qasje në Gjykatën Supreme .....	7
3. Pengesat procedurale që pengojnë ose kufizojnë mundësitë e qasjes në gjykatë .....	8
4. Mosshqyrtimi i akteve administrative individuale të autoriteteve publike.....	9
5. Mosshqyrtimi i kërkesëpadive/ankesave të palëve .....	9
6. Kufizimet procedurale - parimi i imunitetit sovran të shteteve .....	9
II. Shembuj të rasteve të Gjykatës ndërlidhur me të drejtën për qasje në gjykatë .....	10
1. Afatet kohore.....	10
2. Kufizimi <i>ratione valoris</i> .....	12
3. Pengesat procedurale.....	17
a. <i>Përfaqësuesi ligjor</i> .....	17
b. <i>Mospagesa e taksës gjyqësore</i> .....	19
4. Mosshqyrtimi i akteve administrative individuale të autoriteteve publike .....	20
Lista e rasteve.....	23

## Parathënie

Kjo Përmbledhje Tematike e praktikës gjyqësore e publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) ka për qëllim të informojë komunitetin juridik, në veçanti përfaqësuesit e palëve dhe vetë palët në lidhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës, përmes të cilës janë zhvilluar dhe vendosur parimet dhe kriteret që ndërlidhen me shqyrtimin e kërkesave, përmes të cilave pretendohet cenimi i të drejtës për qasje në gjykatë, ashtu siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Përmbledhja Tematike e rasteve të Gjykatës i referohet vetëm atyre aspekteve, për të cilat Gjykata ka arritur të zhvillojë praktikë gjyqësore, përmes të cilës janë aplikuar parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ). Përderisa në lidhje me aspektet tjera, të pambuluara nga praktika gjyqësore e Gjykatës deri më tani, praktikuesit ligjorë dhe lexuesit mund t'i referohen vetë vendimeve të GJEDNJ-së dhe udhëzuesve dhe dokumenteve përkatëse të publikuara në uebfaqen e saj.

Përmes shtjellitimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës që ndërlidhet me vlerësimin e kufizimit të së drejtës për qasje në gjykatë, kjo Përmbledhje Tematike, mes tjerash, në mënyrë të përmbledhur do të elaborojë praktikën gjyqësore të Gjykatës, duke specifikuar rastet më relevante në të cilat Gjykata ka zhvilluar parimet dhe kriteret e përgjithshme të së drejtës për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në të cilat raste, marrë parasysh veçoritë e secilit rast veç e veç, ka aplikuar këto kritere për të vendosur nëse vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta kanë kufizuar të drejtën e parashtruesve përkatës për qasje në gjykatë.

Më specifikisht, në tre kapituj përmbajtësorë, kjo Përmbledhje Tematike në pjesën e saj të parë përvijon dhe shtjellon parimet e përgjithshme dhe më thelbësore përkitazi me të drejtën për qasje në gjykatë dhe përfshinë shembuj konkret se në cilat raste mund të cenohet e drejta për qasje në gjykatë, duke renditur rastet për secilën situatë në të cilën praktika e saj gjyqësore tashmë është e zhvilluar dhe mbi të cilat janë konsoliduar këto parime. Përderisa përmes pjesës së dytë do të pasqyrohen përmbledhjet e disa vendimeve konkrete, në të cilat Gjykata, duke aplikuar parimet dhe kriteret e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore, ka vlerësuar dhe shqyrtuar nëse në rrethanat e rasteve para saj është cenuar e drejta e parashtruesve për qasje në Gjykatë. Në fund, kjo Përmbledhje Tematike përmban edhe listën e vendimeve më relevante të GEJDNJ-së dhe të Gjykatës që ndërlidhen me të drejtën për qasje në gjykatë.

Duhet theksuar se ky dokument është i natyrës informuese dhe se, shtjellitimet dhe çfarëdo reference e përdorur në të, duhet të kuptohet dhe interpretohet në kontekstin e rrethanave faktike dhe juridike të rastit përkatës të vendosur. Prandaj, duke qenë se secili rast ngërthen aspekte thujtë unike faktike e juridike dhe vlerësimi i pranueshmërisë i nënshtrohet shqyrtimit të veçantë rast pas rasti nga Gjykata, referenca në këtë dokument nuk nënkupton detyrimisht rezultatin e caktuar para Gjykatës.

Për më tepër, duhet të sqarohet se përmbajtja e këtij dokumenti dhe referencat në rastet e Gjykatës nuk janë shteruese. Marrë parasysh natyrën dinamike dhe zhvillimin e vazhdueshëm të praktikës gjyqësore, kjo Përmbledhje Tematike do t'i nënshtrohet përditësimit të vazhdueshëm. Të gjitha vendimet e referuara në këtë Përmbledhje janë të publikuara në uebfaqen e Gjykatës dhe janë të qasshme në gjuhën shqipe dhe atë serbe, si gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës, si dhe në raste të caktuara edhe në gjuhën angleze.

## I. E drejta për qasje në gjykatë – Parimet e përgjithshme

### Neni 31(1) dhe (2) i Kushtetutës

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. [...]”

### Neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]”

Gjykata, duke afirmuar konstatimet dhe parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së që burojnë edhe nga detyrimi i saj i përcaktuar me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore në lidhje me të drejtën për qasje në gjykatë si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNJ-së, e cila, ndër të tjera, përfshin rastet (i) [Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 4451/70, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975; (ii) [Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002; (iii) [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), nr.38366/97 dhe nëntë të tjera, Aktgjykim i 25 janarit 2000; dhe (iv) [Nait-Liman kundër Zvicrës](#), nr. 51537/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018. Thënë këtë, rastet e Gjykatës përmes të cilave ajo ka afirmuar parimet e vendosura nga GJEDNJ-ja dhe të njëjtat i ka aplikuar edhe në rastet për shqyrtim para saj, përfshijnë por nuk kufizohen në rastet (i) [KI62/17](#), parashtruese *Emine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018; (ii) [KI224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020; (iii) [KI20/21](#), parashtruese *Violeta Todorović*, Aktgjykim i 13 prillit 2021; (iv) [KI54/21](#) parashtrues *Kamber Hoxha*, Aktgjykim i 4 nëntorit 2021; (v) [KI55/21](#), parashtrues *Muhamet Ademi*, Aktgjykim i 10 marsit 2022; dhe (vi) [KIO4/23](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, Aktgjykim i 30 majit 2024. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykimet e lartcekura, e drejta për qasje në gjykatë, duhet të jetë një e drejtë praktike dhe efektive, ashtu që një individ duhet të ketë mundësi të qartë dhe reale për të kontestuar një akt që pretendohet të cenojë të drejtat e tij/saj të garantuara me Kushtetutë. Thënë këtë, dhe për të dhënë shembuj konkret se në cilat raste mund të cenohet e drejta për qasje në gjykatë, Gjykata do të paraqes raste nga praktika e saj gjyqësore për secilën situatë në të cilën praktika e saj gjyqësore tashmë është e zhvilluar. Për këtë qëllim, në vijim do të paraqiten parimet më thelbësore që janë zhvilluar përmes praktikës gjyqësore në këtë kontekst, duke u pasuar me renditjen e rasteve kryesore mbi të cilat janë konsoliduar këto parime.

E drejta për qasje në gjykatë përcakton që ndërgjyqësit duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre civile.

- [K224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, paragrafi 35; dhe
- [KI20/21](#), parashtrues *Violeta Todorović*, paragrafi 41.

E drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim. Megjithatë kufizimet në këtë të drejtë (i) nuk guxojnë të zvogëlojnë qasjen në gjykatë në atë mënyrë apo deri në një masë që cenojnë vetë thelbin e së drejtës; dhe (ii) nuk do të jenë të arsyetuara nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet.

- [KI20/21](#), parashtruese *Violeta Todorović*, paragrafi 44;
- [KI54/21](#), parashtrues *Kamber Hoxha*, paragrafi 63; dhe
- [KI04/23](#), parashtrues *Avdyll Bajgora*, paragrafi 63.

Gjykata ka konstatuar se e drejta e qasjes në gjykatë vlen edhe për rastet penale.

- [KI62/17](#), parashtruese *Emine Simnica*, paragrafi 54.

Kësisoj, në varësi të rrethanave të rastit, e drejta për qasje në gjykatë mund të cenohet në rastet që, ndër të tjera, ndërlidhen me (1) afatet kohore; (2) kufizimet *ratione valoris* për qasje në Gjykatën Supreme; (3) pengesat procedurale që pengojnë ose kufizojnë mundësitë e qasjes në gjykatë, e që mes tjerash ndërlidhen me (a) mospagesën e taksës gjyqësore; dhe (b) autorizimin e përfaqësuesit ligjor, si në procedurën civile dhe atë penale; (4) mosshqyrtimin e akteve administrative të autoriteteve publike; (5) mosshqyrtimin e kërkesëpadive/ankesave të palëve në procedurë gjyqësore dhe (6) kufizimet procedurale që ndërlidhen me parimin e imunitetit sovran të shteteve.

## 1. Kufizimet që ndërlidhen me afatet kohore

Gjykata, duke afirmuar parimet e zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së ka theksuar se (i) rregullat të cilat përcaktojnë kriteret formale që duhet të respektohen në lidhje me afatin kohor në parashtrimin e një ankese, kanë për qëllim administrimin e mirëfilltë të drejtësisë dhe të njëjtat duhet të shqyrtohen në pajtueshmëri, e në veçanti në pajtim me parimet e sigurisë juridike; (ii) çdo rast duhet të shqyrtohet në dritën e rrethanave dhe elementeve specifike të procedurës në atë rast; dhe (iii) gjykatat duhet të mënjanojnë si “*formalizmin e tepruar*” që do ta pamundësonte procedurën e drejtë ashtu edhe “*fleksibilitetin e tepruar*” që do t'i bënte kriteret procedurale të përcaktuara me ligj joefektive.

- [KI54/21](#), parashtrues *Kamber Hoxha*, paragrafi 76; dhe
- [KI55/21](#), parashtrues *Muhamet Ademi*, paragrafi 72.

Gjykata, nga këndvështrimi i administrimit të mirëfilltë të drejtësisë dhe i respektimit të parimit të sigurisë juridike gjatë interpretimit dhe aplikimit të dispozitave përkatëse ligjore nga ana e gjykatës përkatëse duhet të vlerësojë nëse e njëjta (i) ka marrë për bazë rrethanat specifike të rastit, përkatësisht rrethanat e procedurës së zhvilluar para gjykatave të rregullta, dhe në kuptim të kësaj të fundit (ii) ka mënjeluar “*formalizmin e tepruar*”.

- [KI54/21](#), parashtrues *Kamber Hoxha*, paragrafi 77; dhe
- [KI55/21](#), parashtrues *Muhamet Ademi*, paragrafi 73.

Në rast të vlerësimit të asaj se si rezultat i interpretimit formalist dhe aplikimit të rregullave përkatëse procedurale që ndërlidhen me afatshmërinë e paraqitjes së parashtrësive dhe ankesave nga ana e gjykatave të rregullta, atëherë Gjykata ka gjetur se konstatimi i tyre në lidhje me afatshmërinë e parashtrësive/ankesave ka pushuar të jetë në shërbim të parimit të sigurisë juridike, i cili për pasojë ka cenuar të drejtën e qasjes së parashtruesit të kërkesës në gjykatë.

- [KI54/21](#), parashtrues *Kamber Hoxha*, paragrafi 86; dhe
- [KI55/21](#), parashtrues *Muhamet Ademi*, paragrafi 82.

Llogaritja e pasaktë e afateve të përcaktuara me Ligjin e Punës nga ana e Gjykatës Supreme, rezultoi në mohimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

- [KI38/23](#), parashtrues *Flamur Dylhasi*, paragrafi 86.

Gjykata ka theksuar se kufizimi i vendosur nga Gjykata Supreme për qasje në këtë gjykatë si rezultat i konstatimit të saj se revizioni i parashtruar nga parashtruesja e kërkesës ishte dorëzuar jashtë afatit, duke anashkaluar të drejtën e parashtrueses për pranimin e vendimit të Gjykatës së Apelit në gjuhën e saj amtare, përkundër faktit që bazuar në ligjin e aplikueshëm kjo ishte gjuha e zgjedhur në procedurë gjyqësore, ishte joproporcional dhe për pasojë, ka cenuar vetë thelbin e të drejtës për qasje në gjykatë.

- [KI84/22](#), parashtruese *Slavica Đorđević*, paragrafi 87.

## 2. Kufizimet *ratione valoris* në të drejtën për qasje në Gjykatën Supreme

Bazuar në paragrafin 2 të nenit 211 (pa titull) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK): “*Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro*”. Rrjedhimisht, natyra e kufizimit *ratione valoris* e bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, bazohet në paragrafin 2 të nenit 211 (pa titull) të LPK-së. Thënë këtë, në momentin e arritjes së këtij pragu, Gjykata Supreme bazuar në nenin 223 (pa titull) të LPK-së mund të anulojë vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët dhe të kthejë çështjen në rivendojse në gjykatën e shkallës më të ulët apo edhe të anulojë vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët dhe për pasojë të refuzojë kërkesëpadinë e palëve.

- [KI04/23](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, paragrafi 76; dhe
- [KI172/23](#), parashtruese *Rejhane Ceka, Fiknete Ceka, Lejlane Ceka dhe Sara Ceka*, paragrafi 77.

Gjykata ka theksuar se në kuptim të administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, aplikimi i rregullave formale dhe procedurale që ndërlidhen me lejueshmërinë e revizionit është i një rëndësie të tillë që i shërben sigurisë juridike gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore para Gjykatës Supreme. Në përcaktimin e këtyre parimeve, Gjykata duke aplikuar parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në veçanti të rastit *Zubac kundër Kroacisë*, ka theksuar se (i) kufizimi i qasjes në atë gjykatë duke vendosur një prag ligjor *ratione valoris* justifikohet nga qëllimi legjitim i Gjykatës Supreme që të merret vetëm me çështje më të rëndësishme; dhe (ii) zgjidhja e parregullsive të kryera nga gjykatat më të ulëta në përcaktimin e vlerës së kontestit synon gjithashtu një qëllim legjitim, përkatësisht respektimin e shtetit të së drejtës dhe funksionimin e duhur të sistemit gjyqësor.

Në vijim të këtij qëndrimi, Gjykata aplikon kriteret e zhvilluara përmes GJEDNJ-së në rastin *Zubac kundër Kroacisë*, dhe të afirmuara përmes praktikës së saj tashmë të konsoliduar gjyqësore në këto raste, përkatësisht vazhdon me vlerësimin e asaj nëse (a) në lidhje me kriterin e parashikueshmërisë së kufizimit përmes pragut ligjor, praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme është konsistente dhe e qartë në lidhje me lejueshmërinë e revizionit; (b) kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme mund t'i atribuohet parashtruesit të kërkesës; dhe (c) nëse Gjykata Supreme gjatë interpretimit dhe zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi që ndërlidhen me prapun e lejueshmërisë së revizionit ka përdorur “*formalizëm të tepruar*”.

- [KI04/23](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, paragrafi 74;
- [KI172/23](#), parashtruese *Rejhane Ceka, Fiknete Ceka, Lejlane Ceka dhe Sara Ceka*, paragrafi 75;
- [KI199/22](#), parashtrues *P.T.P. “Arta XH”*, paragrafi 79; dhe
- [KI96/22](#), parashtrues *Naser Husaj dhe Uliks Husaj*, paragrafi 58.

### 3. Pengesat procedurale që pengojnë ose kufizojnë mundësitë e qasjes në gjykatë

- *Pengesat që ndërlidhen me autorizimin e përfaqësuesit ligjor në procedurë para gjykatave të rregullta*

E drejta e “*qasjes në gjykatë*” nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individit duhet të ketë gjithashtu një mundësi “*të qartë dhe reale*” për të kontestuar vendimin që shkelë të drejtat e tij/saj dhe që rasti i tij/saj të trajtohet në merita. Kësisoj, refuzimi i mjeteve juridike të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës para gjykatave të rregullta, ku këto të fundit nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim procedural që buron nga ligji për të konstatuar vërtetësinë e fakteve rreth përfaqësimit, sipas Gjykatës përbën kufizim të së drejtës për qasje në gjykatë.

- [KI62/17](#), parashtruese *Emine Simnica*, paragrafi 74 [procedurë penale]; dhe
- [KI182/20](#), parashtrues *Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi*, paragrafi 99 [procedurë civile].
- *Mospagesa e taksës gjyqësore*

Gjykata vlerësoi se barra e përgjegjësisë për mosadministrimin e parashtresave të parashtruesit të kërkesës i takon gjykatës, në rast se parashtruesi i kërkesës ka ndërmarrë çdo veprim që i është kërkuar me dispozitat ligjore në fuqi, për t’u siguruar se ankesa e tij të shqyrtohej në merita.

- [KI224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, paragrafi 53; dhe
- [K80/19](#), parashtrues *Radomir Dimitrijević*, paragrafi 62.



#### 4. Mosshqyrtimi i akteve administrative individuale të autoriteteve publike

Mosshqyrtimi i padisë së parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me vlerësimin e dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës nga Gjykata Themelore, e Apelit dhe ajo Supreme, cenoi të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në drejtësi.

- [KI214/21](#), parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022, paragrafi 129.

Refuzimi i gjykatave të rregullta për të shqyrtuar ligjshmërinë e akteve nënligjore, paraqet cenim të së drejtës për qasje në gjykatë. Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nën ligjore nga gjykatat e rregullta është detyrim ligjor dhe kushtetues i këtyre të fundit.

- [KI10/22](#), parashtrues *Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 18 korrikut 2021, paragrafi 80.

#### 5. Mosshqyrtimi i kërkesëpadive/ankesave të palëve

Pamundësia për të adresuar objektin e kërkesëpadisë dhe pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesit e kërkesës nëpërmjet parashtrësive/mjeteve juridike, respektivisht nga ana e gjykatave të rregullta, dhe mosriparimi i shkeljes të kësaj të drejte nga gjykata e shkallës më të lartë përbën një të metë procedurale, e cila si rrjedhojë cenon vetë thelbin e të drejtës së parashtruesve të kërkesës për të marrë një përgjigje meritore në lidhje me çështjen e tyre.

- [KI49/23](#), parashtrues *Shaban Dulahu dhe të tjerët*, paragrafi 93; dhe
- [KI121/22](#), parashtrues *Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi*, paragrafi 82.

#### 6. Kufizimet procedurale - parimi i imunitetit sovran të shteteve

Gjykata, mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka afirmuar se kufizimi i të drejtës për qasje në gjykatë ndjek një qëllim legjitim dhe është proporcional në rast të barrierave procedurale të cilat i imponon parimi i imunitetit sovran të shteteve - si një nga parimet themeltare të së drejtës ndërkombëtare publike - në raport me procedurat gjyqësore që mund të zhvillohen kundër një shteti në gjykatat e brendshme të një shteti tjetër (shih, rastet e GJEDNJ-së: [Jones dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 34356/06 dhe 40528/06, Aktgjykim i 14 janarit 2014; dhe [Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 35763/97, Aktgjykimi i 21 nëntorit 2001).

Në rastet që ndërlidhen me kërkesat para Gjykatës, që i referohen kërkesave të parashtruesve të kërkesës kundër Qeverisë së Serbisë për kompensim të dëmeve të luftës të shkaktuara gjatë luftës në Kosovë, Gjykata gjeti se gjykatat e rregullta të Kosovës nuk kanë gjykuar mbi të drejtën e parashtruesve të kërkesës për të kërkuar kompensimin e dëmit, por vetëm lidhur me kompetencën territoriale të gjykatave të Kosovës për të zhvilluar procedurë kundër një shteti tjetër.

- [KI147/20](#), [KI148/20](#), [KI149/20](#), [KI150/20](#), [KI151/20](#) dhe [KI152/20](#), parashtrues *Nezir Neziri dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për Papranueshmëri, 1 janarit 2021, paragrafët 58-60; (shih edhe të gjitha vendimet tjera të Gjykatës ndërlidhur me kërkesat e ngjashme të parashtruara para saj).

## II. Shembuj të rasteve të Gjykatës ndërlidhur me të drejtën për qasje në gjykatë

Në vijim do të pasqyrohen përmbledhjet e disa vendimeve konkrete, në të cilat Gjykata, duke aplikuar parimet dhe kriteret e lartcekura të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore, ka vlerësuar dhe shqyrtuar nëse në rrethanat e rasteve para saj është cenuar e drejta e parashtruesve për qasje në gjykatë. Përmbledhjet e pasqyruara si në vijim janë të thjeshtëzuara dhe përmbajnë esencën e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe konstatimit të Gjykatës, dhe për këtë arsye çdo interpretim dhe analizë e tyre duhet të bërë në dritën e Aktgjykimit/Aktvendimit të publikuar.

### 1. Afatet kohore

KI54/21, parashtrues *Kamber Hoxha*, Aktgjykim i 4 nëntorit 2021

#### **Parimi:**

Konstatimi i Gjykatës Supreme se kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është paraqitur jashtë afatit ligjor, pas një dekade procedurash në të cilat padia e parashtruesit të kërkesës ishte vendosur e rivendosur në merita përfshirë nga vet Gjykata Supreme, nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur për garantimin e sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, si një ndër parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.

#### **Faktet:**

Parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar pranë Shërbimit Korrektues. Në vitin 2004, ai u njoftua me anë të vendimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës si shkas i shkeljeve disiplinore. Fillimisht, parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar procedurë administrative duke kontestuar vendimin dhe pastaj kishte filluar procedurat edhe pranë gjykatave të rregullta. Kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ishte shqyrtuar nga aspekti procedural dhe i meritave në procedurat e zhvilluara në Gjykatën e Qarkut, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme. Çështja ishte kthyer në rivendosje në Gjykatën Themelore, e cila sërish kishte aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit, kishte prishur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke e refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, kësaj radhe duke konstatuar se padia fillestare ishte paraqitur jashtë afateve ligjore siç është përcaktuar në Ligjit për të Drejtat Themelore të Marrëdhënies së Punës të 28 shtatorit 1989 të RSFJ-së. Duke vepruar sipas kërkesës për revizion, Gjykata e Supreme konfirmoi qëndrimin e Gjykatës së Apelit.

#### **Pretendimet:**

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës i kontestoi konstatimet e lartcekura të Gjykatës Supreme, përfshirë edhe ato të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar se të njëjtat janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë e mishëruara në të drejtat e tij kushtetuese që ndërlidhen me të drejtën e tij për mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore e të drejtave.

#### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata konstatoi se në rrethanat e rastit konkret duhet marrë parasysh faktin që edhe Gjykata e Apelit edhe ajo Supreme, kishin vendosur njëherë lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës, duke mos ngritur asnjëherë çështjen e afatshmërisë së padisë fillestare. Në rrethana të tilla, Gjykata vuri theks në interpretimin tejet formalist në lidhje me aplikueshmërinë e dispozitave të Ligjit për të Drejtat Themelore të Marrëdhënies së Punës të

28 shtatorit 1989 të RSFJ-së nga ana e Gjykatës Supreme, duke rezultuar në konstatimin se padia fillestare e parashtruesit të kërkesës ishte e pasafatshme, përkundër faktit që vet Gjykata Supreme, në shqyrtimin e kësaj çështje radhën e parë, nuk e kishte ngritur çështjen e afatshmërisë së kërkesëpadisë. Sipas vlerësimit të Gjykatës, konstatimi i Gjykatës Supreme, pas një dekade procedurash në të cilat padia e parashtruesit të kërkesës ishte vendosur e rivendosur në merita përfshirë vet Gjykatën Supreme, nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur për garantimin e sigurisë juridike dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, si një ndër parimet bazë të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike.

#### **Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së për shkak se si rezultat i këtij interpretimi dhe konstatimi të Gjykatës Supreme, parashtruesit të kërkesës i është mohuar “*e drejta e tij e qasjes në gjykatë*”.

**Referenca:** [KI54/21](#)

[KI20/21](#), parashtruese *Violeta Todorović*, Aktgjykim i 13 prillit 2021

#### **Parimi:**

Hedhja poshtë e kërkesës së parashtrueses së kërkesës për përmirësimin e gabimit teknik të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që ndërlidhen me Agjencinë për Privatizim të Kosovës, si rezultat i të cilit gabim parashtruesja e kërkesës nuk kishte mundësi të ushtronte mjetin juridik – ankesën, sepse e njëjta ishte hedhur poshtë si e pasafatshme, cenon të drejtën e saj për qasje në gjykatë.

#### **Faktet:**

Parashtruesja e kërkesës ishte e punësuar në N.Sh. “Yumco” që nga viti 1990. Pas privatizimit të kësaj të fundit, Agjencia Kosovare e Privatizimit publikoi listën përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në N. Sh. “Yumco”, në të cilën listë parashtruesja e kërkesës nuk ishte e përfshirë. Ajo paraqiti ankesë pranë Kolegjit të Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës për Çështje që ndërlidhen me Agjencinë për Privatizim të Kosovës (DHPGJS), i cili hodhi poshtë si të pabazuar ankesën. Duke vepruar sipas ankesës, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së gjithashtu hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës me arsyetimin se ishte paraqitur jashtë afatit të përcaktuar me ligj. Pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, parashtruesja e kërkesës, parashtroi kërkesë për përmirësimin e gabimit teknik të Aktvendimit të Kolegjit të Apelit, duke arsyetuar se e njëjta kishte parashtruar ankesën brenda afatit ligjor. Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit të radhës, e hodhi poshtë kërkesën e parashtrueses së kërkesës si të papranueshme, duke shtuar se vendimi i Kolegjit të Apelit është përfundimtar, edhe pse erdhi në përfundim që deklaratat e parashtrueses së kërkesës që vendimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së është pranuar nga parashtruesja, më 3 qershor 2016, ishin të sakta.

#### **Pretendimet:**

Parashtruesja e kërkesës në thelb pretendoi para Gjykatës Kushtetuese se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me të drejtën e saj për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata konstatoi se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përkundër faktit që konstatoi se pretendimet e parashtrueses së kërkesës në lidhje me gabimin ishin të sakta, dhe se rrjedhimisht ankesa e saj ishte parashtruar sipas afateve të përcaktuara përmes Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i njëjti e refuzoi kërkesën e parashtrueses për përmirësim të gabimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së përmes Aktgjykimit të 4 tetorit 2019, duke e konsideruar kërkesën e saj si kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së i kufizoi parashtrueses së kërkesës qasjen në gjykatë, si një ndër parimet kryesore të një gjykimi të drejtë.

### **Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së sepse vendimet e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së rezultuan në pamundësinë që ankesa e parashtrueses së kërkesës ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të trajtohej në merita përkundër faktit që ankesa e saj ishte paraqitur brenda afatit ligjor.

**Referenca:** [KI20/21](#)

## 2. Kufizimi *ratione valoris*

[KI04/23](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, Aktgjykim i 30 majit 2024

### **Parimi:**

Interpretimi tejet formalist i rregullave procedurale nga ana e Gjykatës Supreme në lidhje me vlerën e objektit të kontestit, përkatësisht kufizimit *ratione valoris*, si kriter për lejueshmërinë e mjetit juridik – revizionit, në rastin konkret, rezultoi në kufizimin e së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë.

### **Faktet:**

Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesën e tij të parë në Gjykatë, të regjistruar me numrin KI143/21, përmes së cilës kontestoi Aktvendimin përkatës të Gjykatës Supreme të 22 shkurtit 2021 që ndërlidhej me kërkesëpadinë e tij për kompensim të 3 (tri) pagave jubilarë nga Korporata Energjetike e Kosovës, pasi kjo e fundit kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për njohjen e të drejtës në kompensimin e lartcekur. Gjykata Themelore në Prishtinë aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, ndërkaq Gjykata e Apelit ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në pikën I të dispozitivit të tij dhe e refuzoi si të pabazuar në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht vlerën e tërësishme të objektit të kontestit, shumë prej 3,286.80 euro.

Në shqyrtimin e kërkesës për revizion të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit të 22 shkurtit 2021, kishte konstatuar se revizioni në këtë rast nuk është i lejuar, sepse vlera e kontestit nuk e kalonte shumë prej 3,000.00 euro ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 211 (pa titull) të LPK-së.

Në rastin KI143/21, Gjykata, përmes Aktgjykimit të saj të 25 nëntorit 2021, konstatoi se Aktvendimi [Rev. nr. 558/2020] i Gjykatës Supreme, i 22 shkurtit 2021, ishte nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces

të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për pasojë rastin e ktheu në rivendosje në Gjykatën Supreme.

Në vijim, Aktgjykimi sqaron se si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të 25 nëntorit 2021 në rastin KI143/21, Gjykata Supreme më 10 tetor 2022, nxori Aktvendimin [Rev. nr.43/2022] përmes të cilit sërish hodhi poshtë revizionin e parashtruesit të kërkesës si të palejuar, kësaj here duke shprehur edhe mospajtimin e saj me konstatimet e dhëna në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Supreme, në thelb, konstatoi se vlera e kontestit nuk kalonte shumë prej 3,000.00 euro ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së, kjo për shkak se sipas saj (i) përgjigja në ankesë nuk mund të trajtohet si ankesë dhe e njëjta nuk është mjet juridik ankimor, dhe rrjedhimisht, nuk mund të trajtohet si e tillë pavarësisht se çka propozon pala që e paraqet atë; (ii) edhe sikurse përgjigja në ankesë të trajtohej si ankesë, e njëjta rezulton që është paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e LPK-së; dhe se (iii) përgjigja në ankesë nuk i përmban elementet që janë përcaktuar me nenin 178 (pa titull) të LPK-së.

#### **Pretendimet:**

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se atij sërish i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse Gjykata Supreme veproi në kundërshtim me konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI143/21.

#### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata elaboroi parimet e të drejtës për qasje në gjykatë, duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, më konkretisht në rastin *Zubac kundër Kroacisë*, përfshirë këtu dhe parimet dhe kriteret e zhvilluara nga GJEDNJ që ndërlidhen me kufizimin *ratione valoris* për qasje në gjykata të shkallës më të lartë. Gjykata konstatoi se, marrë për bazë vetë thelbin e juridiksionit dhe kompetencës së Gjykatës Supreme për të gjykuar për çështje të ligjshmërisë së vendimeve të nxjerra nga gjykata e shkallës më të ulëta si autoriteti më i lartë gjyqësor, pragu *ratione valoris* (i) është i përcaktuar me ligj; (ii) ndjek një qëllim legjitim, i cili i shërben respektimit të sundimit të ligjit dhe administrimit të mirëfilltë të drejtësisë; megjithatë, (iii) në vlerësimin e asaj nëse ky kufizim ishte proporcional me qëllimin legjitim, Gjykata vuri theks në përcaktimet e Aktgjykimit të goditur të Gjykatës së Apelit në pikën I të dispozitivit të saj kishte përcaktuar refuzimin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës “në shumë të përgjithshme prej 3,286,80 euro”, që tejkalon kufizimet *ratione valoris* sipas përcaktimeve të ligjit të aplikueshëm. Gjykata vlerësoi se një interpretimi tejet formalist i rregullave të pragut të vlerës së objektit në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, e që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlidhen me Aktgjykimin e goditur të Gjykatës së Apelit, bie ndesh me kriterin e garantimit të së drejtës praktike dhe efektive të qasjes në gjykatë në kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

#### **Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, i cili për herë të dytë hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës përbën një “*formalizëm të tepruar*” bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, i cili ka rezultuar në interpretim dhe zbatim tejet strikt të rregullave procedurale, të përcaktuara me legjislationin në fuqi dhe për pasojë në mënyrë të pajustificuar ka cenuar qasjen e parashtruesit të kërkesës në juridiksionin e saj, duke krijuar një pengesë që çështja e tij të zgjidhej në merita. Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

**Referenca:** [KI04/23](#)

**KL172/23**, parashtruese *Rejhane Ceka, Fiknete Ceka, Lejlane Ceka dhe Sara Ceka*, Aktgjykim i 30 majit 2024

#### **Parimi:**

Aplikimi i pragut *ratione valoris* nga Gjykata Supreme nuk mori parasysh ndërlidhjen në mes kërkesave të parashtruesve, të cilat ishin të mbështetura në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, sjellje e cila rezultoi në “*formalizëm të tepruar*”, e rrjedhimisht kufizoi të drejtën e parashtrueseve të kërkesës për të marrë një vendim merititor.

#### **Faktet:**

Parashtrueset e kërkesës, së bashku me prindërit e tyre, kishin paditur një kompani sigurimesh për kompensim të dëmit material dhe jomaterial për vdekjen e vëllait të tyre në një aksident komunikacioni, ku ai ishte i siguruar. Gjykata Themelore miratoi kërkesën dhe kompensoi parashtrueset me 8,000 euro secilën për dëmin jo-material, ndërsa prindërit me 10,000 euro secilin. Pas ankesës së kompanisë së sigurimeve, Gjykata e Apelit e uli shumën për parashtrueset në 5,000 euro për secilën, duke e miratuar kompensimin për prindërit. Parashtrueset e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme, ku kjo e hodhi poshtë si të palejuar, duke argumentuar se vlera e kontestit për secilën parashtruese të kërkesës nuk e tejkalonte vlerën prej 3,000 eurosh.

#### **Pretendimet:**

Parashtrueset e kërkesës pretenduan se vendimi i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tyre për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës duke argumentuar se (i) vlera e kontestit e kalon pragun prej 3,000 eurosh; dhe se (ii) kërkesat e tyre janë të lidhura dhe përbëjnë një kërkesë të vetme të bazuar në të njëjtat rrethana faktike dhe juridike. Ato argumentojnë se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme është bërë në mënyrë të tepruar dhe formaliste, duke cenuar kështu të drejtën e tyre për qasje në gjykatë.

#### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata elaboroi parimet e të drejtës për qasje në gjykatë, duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, më konkretisht në rastin *Zubac kundër Kroacisë*, përfshirë këtu dhe parimet dhe kriteret e zhvilluara nga GJEDNJ që ndërlidhen me kufizimin *ratione valoris* për qasje në gjykata të shkallës më të lartë. Gjykata vlerësoi se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme për shkak të pragut *ratione valoris* ishte një kufizim legjitim, por duhej të shqyrtohej nëse ishte proporcional. Gjykata vlerësoi se vendimi i Gjykatës Supreme ishte karakterizuar me formalizëm të tepruar, kështu duke rezultuar në interpretim dhe zbatim të “*izoluar*” të ligjit. Për më tepër, Gjykata theksoi se ishte detyrë e Gjykatës Supreme të shqyrtonte dispozitat ligjore në tërësi dhe të merrte parasysh lidhjen e tyre me kërkesat e parashtrueseve të kërkesës. Gjykata sqaroi se detyrë primare e Gjykatës Supreme është që dispozitat relevante të LPK-së që ndërlidhen me bashkë-ndërgjyqësinë dhe përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, t'i shtjellojë dhe aplikojë në tërësinë e tyre dhe jo në mënyrë të izoluar, përkatësisht, që e njëjta aplikimin e nenit 211 (pa titull) të LPK-së në ndërlidhje me nenin 268 (pa titull) të LPK-së, nuk do të duhej ta bënte në anashkalim të plotë të nenit 32 (pa titull) të LPK-së, i cili saktëson përcaktimin e vlerës së objektit atëherë kur kërkesëpaditë përkatëse janë mbështetur në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, pasi që aplikimi dhe/ose arsyetimi për mosaplikimin e tyre ishte vendimtar për palët apo parashtrueset e revizionit, në rrethanat e rastit konkret.

**Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se Aktvendimi i kontestuar Gjykatës Supreme nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së në kontekst të garancive që ndërlidhen me të drejtën për qasje në gjykatë.

**Referenca:** [KI172/23](#)

**KI199/22**, parashtrues *P.T.P. “Arta XH”*, Aktgjykim i 30 majit 2024

**Parimi:**

Dështimi i gjykatave të shkallës më të ulët për të përcaktuar vlerën e kontestit nuk mund të rezultojë në pamundësinë e parashtruesit të kërkesës për të pasur qasje në Gjykatën Supreme.

**Faktet:**

Rasti ndërlidhet me një kontest për kompensim dëmi mes parashtruesit të kërkesës dhe një kompanie me të cilën kishin lidhur një kontratë për shitjen e mbetjeve metalike në vitin 2002. Në dhjetor 2010, kompania u privatizua dhe u regjistrua si person i ri juridik, duke vazhduar kështu përmbushjen e detyrimeve kontraktuale deri më 19 gusht 2011, kur e ndërpreu kontratën me parashtruesin në mënyrë të njëanshme. Pas kësaj, parashtruesi filloi një procedurë ligjore për të kërkuar kompensimin e dëmit, duke kërkuar që vlera e objektit të kontestit të përcaktohej përmes provave dhe ekspertizës financiare. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit e refuzuan padinë në tërësi, duke përfshirë kërkesën për përcaktimin e vlerës së kontestit. Më pas, kërkesa për revizion në Gjykatën Supreme u hodh poshtë për arsye procedurale, me arsyetimin se vlera e objektit të kontestit nuk e kishte tejkaluar pragun prej 10,000.00 euro sipas nenit 508 (pa titull) të LPK-së.

**Pretendimet:**

Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, duke pretenduar se ai shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, duke argumentuar që (i) vendimi i Gjykatës Supreme kishte cenuar të drejtën e tij për qasje në gjykatë, për shkak se, përkundër kërkesës së vazhdueshme, vlera e kontestit nuk ishte përcaktuar në procedurë gjyqësore; (ii) gjykatat kishin dështuar të përcaktonin vlerën e objektit të kontestit sipas detyrës zyrtare, siç kërkohet nga LPK; dhe (iii) Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën për revizion mbi bazën e vlerës së kontestit, duke anashkaluar dështimin e gjykatave më të ulëta për të përcaktuar këtë vlerë.

**Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata elaboroi parimet e të drejtës për qasje në gjykatë, duke u mbështetur në praktikën e GJEDNJ-së, më konkretisht në rastin [Zubac kundër Kroacisë](#), përfshirë këtu dhe parimet dhe kriteret e zhvilluara nga GJEDNJ që ndërlidhen me kufizimin *ratione valoris* për qasje në gjykata të shkallës më të lartë. Gjykata vlerësoi se vendimi i Gjykatës Supreme, i bazuar në një interpretim të ngushtë të ligjit, përbënte “*formalizëm të tepruar*” dhe se dështimi i gjykatave më të ulëta për të përcaktuar vlerën e objektit të kontestit, detyrim ky i përcaktuar me nenin 36 (pa titull) të LPK-së, nuk duhej të cenonte të drejtat e parashtruesit. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kufizimi i vendosur nga Gjykata Supreme, nuk ishte proporcional me qëllimin legjitim të garantimit të qasjes në gjykatat më të larta.

**Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se Aktvendimi i kontestuar Gjykatës Supreme nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së në kontekst të garancive që ndërlidhen me të drejtën për qasje në gjykatë.

**Referenca:** [KI199/22](#)

**KI96/22**, parashtrues *Naser Husaj dhe Ulks Husaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2023

**Parimi:**

Kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme përmes pragut ligjor *ratione valoris* justifikohet nga qëllimi legjitim i kësaj të fundit dhe si rrjedhojë aplikimi i rregullave procedurale nga ana e gjykatave të rregullta që ndërlidhen me përcaktimin e vlerës së objektit në një fazë më të hershme të procedurës, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm nuk përbën kufizim jo proporcional të së drejtës së parashtruesve të kërkesës për qasje në gjykatë.

**Faktet:**

Parashtruesi i kërkesës në cilësinë e përfaqësuesit të pretenduar të pronarit të ndjerë M.M. kishte lidhur kontratë për shitblerjen e pronës [në pronësi të M.M.] me parashtruesin tjetër të kërkesës, njëkohësisht dhe biri i tij, e cila kontratë u vërtetua nga Gjykata Komunale në Istog. Trashëgimtarët e të ndjerit, M.M., parashtruan padi në Gjykatën Themelore duke kërkuar anulimin e kontratës së tillë, meqenëse e njëjta ishte lidhur pa një autorizim valid nga pronari i paluajtshmërisë, përkatësisht M.M. Gjykata Themelore anuloi kontratën, me arsyetimin se autorizimi me të cilin ishte autorizuar parashtruesi i kërkesës ishte jo valid për faktin se pronari i paluajtshmërisë kishte ndërruar jetë para nënshkrimit të saj. Njëkohësisht, në Gjykatën Themelore ishte përcaktuar vlera e kontestit nën shumën 3,000. 00 euro. Gjykata e Apelit vërtetoi konstatimet e Gjykatës Themelore, ndërkaq revizioni i paraqitur në Gjykatën Supreme nga parashtruesit e kërkesës, u hodh poshtë si i palejuar sepse vlera e objektit të kontestit nuk kalon shumën prej 3,000. 00 euro sipas përcaktimeve të LPK-së.

**Pretendimet:**

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se konstatimi i Gjykatës Supreme se revizioni i tyre është i palejuar, përbën shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe kontestuan konstatimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit që ndërlidhen me anulimin e kontratës së shitblerjes për shkak të autorizimit jo-valid, kështu duke pretenduar shkelje të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të drejtës së tyre në pronë të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

**Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata në shqyrtimin e këtij rasti, iu referua rastit të GJEDNJ-së [Zubac kundër Kroacisë](#). Kësisoj, Gjykata konstatoi se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme nuk ishte rezultat i rregullave procedurale jo-fleksibile, për arsye se dispozitat e LPK-së, përkatësisht neni 36 (pa titull) i tij, parashih mundësinë e ndryshimit të vlerës së objektit të kontestit në një fazë më të hershme të procesit gjyqësor, përkatësisht gjatë zhvillimit të procedurës para Gjykatës Themelore. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës në dispozicion kishte edhe mjetin tjetër të jashtëzakonshëm të goditjes, atë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të përcaktuar me



nenin 245 (pa titull) të LPK-së, të cilin nuk e kishte shfrytëzuar. Gjykata në pajtim me konstatimin dhe qëndrimin e GEJDNJ-së konkludoi se kufizimi i qasjes në Gjykatën Supreme përmes pragut ligjor *ratione valoris* justifikohet nga qëllimi legjitim i Gjykatës Supreme që të merret vetëm me çështje më të rëndësishme, dhe si rrjedhojë, në rrethanat e rastit konkret, nuk përbën kufizim jo proporcional të së drejtës së parashtruesve të kërkesës për qasje në gjykatë, marrë parasysh që janë zbatuar procedurat e përcaktuara me ligjin e aplikueshëm.

#### **Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i konstatimit se revizioni i tyre ishte i palejuar, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese për shkak të “*mungesës së dukshme apo evidente të shkeljes*”, ashtu siç përcaktohet me Rregulloren e punës së Gjykatës.

**Referenca:** [KI96/22](#)

### 3. Pengesat procedurale

#### *a. Përfaqësuesi ligjor*

[KI62/17](#), parashtruese *Emine Simnica*, Aktgjykim i 29 majit 2018

#### **Parimi:**

Mosverifikimi i autorizimit të përfaqësuesit ligjor të parashtrueses së kërkesës nga Gjykata Supreme, dhe rrjedhimisht refuzimi i kërkesës së parashtrueses në procedurë të shkurtër, në rrethanat e rastit konkret, përbën në shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë.

#### **Faktet:**

Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte ngritur aktakuzë kundër parashtrueses së kërkesës dhe rrjedhimisht me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesja e kërkesës u shpall fajtoare për kryerjen e veprës përkatëse penale. Prokurori i Shtetit parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër këtij aktgjykimi dhe Gjykata e Apelit nxori aktgjykim me të cilin aprovoi ankesën e Prokurorit të Shtetit dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë. Parashtruesja e kërkesës kishte pasur të njëjtin përfaqësues pranë Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit, ndërkaq në Gjykatën Supreme parashtruesja e kërkesës kishte përfaqësues ligjor tjetër. Parashtruesja e kërkesës kundër vendimit të Gjykatës së Apelit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme, e kjo e fundit nxori vendimin duke hedhur poshtë, si të palejueshme, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së përfaqësuesit ligjor të parashtrueses së kërkesës pa verifikuar autorizimin e saj.

#### **Pretendimet:**

Parashtruesja e kërkesës pretendoi se Gjykata Supreme me aktvendimin e saj për hedhje poshtë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nuk e përmbushi detyrimin e saj të parashikuar me ligj, sepse ia refuzoi asaj mundësinë e korrigjimit dhe plotësimit të parashtrësave të saj, duke ia mohuar asaj të drejtën për qasje në gjykatë.

**Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata vlerësoi se Gjykata Supreme nxori një vendim, me të cilin e refuzoi me procedurë të shkurtër kërkesën e parashtrueses në baza procedurale, pa i lejuar asaj të sqaronte identitetin e përfaqësuesit të saj ligjor, përkundër detyrimeve që burojnë nga ligji i aplikueshëm. Në këtë mënyrë, Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme e kufizoi qasjen e parashtrueses se kërkesës në gjykatë, sepse kufizimet e tilla të Gjykatës Supreme nuk ndiqnin një qëllim legjitim që do të lejonte marrjen e një vendimi për meritat në këtë rast, prej nga rezultoi se nuk kishte marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura nga Gjykata Supreme dhe qëllimit të ndjekur, që do të rezultonte në nxjerrjen e një vendim përfundimtar lidhur me kontestin e rastit.

**Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se Aktvendimi i kontestuar Gjykatës Supreme nuk është në përputhshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së në kontekst të garancive që ndërlidhen me të drejtën për qasje në gjykatë.

**Referenca:** [KI62/17](#)

[KI182/20](#), parashtrues *Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi*, Aktgjykim i 20 janarit 2022

**Parimi:**

Refuzimi i revizionit të parashtruesve të kërkesës nga Gjykata Supreme, i cili ishte paraqitur nga avokati i ri i këtyre të fundit, me arsyetimin se në shkresat e lëndës nuk ekziston autorizimi me të cilën parashtruesit e kërkesës autorizuan avokatin E.G., për t'i përfaqësuar në Gjykatën Supreme, përbën cenim të së drejtës për qasje në gjykatë.

**Faktet:**

Parashtruesit e kërkesës kishin iniciuar procedurë kontestimore në Gjykatën Komunale në Prizren, kundër Komunes së Prizrenit, përmes së cilës kërkuan që të konstatohet se janë bashkëpronarë të një prone. Parashtruesit e kërkesës, gjithsecili individualisht, autorizuan avokatin S.R., që t'i përfaqësoj ata, si dhe në autorizimin e dhënë kishin përfshirë edhe klauzolën që, avokati S.R., ka të drejtë të transferoj autorizimin te një avokat tjetër. Çështja kaloi në rivendosje sipas vendimit të Gjykatës Supreme, në të cilën procedurë avokati S.R., transferoi të drejtën për përfaqësim të parashtruesve të kërkesës te avokati E.G., i cili paraqiti revizion në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit, e hodhi poshtë si të palejueshëm revizionin, duke arsyetuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston autorizimi me të cilin parashtruesit e kërkesës autorizuan avokatin E.G., për t'i përfaqësuar ata pranë Gjykatës Supreme.

**Pretendimet:**

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se Aktvendimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me Kushtetutë, sepse Gjykata Supreme kishte vepruar në kundërshtim me garancitë procedurale për qasje në gjykatë, kështu duke mos kërkuar sqarimin/dorëzimin e autorizimit nga parashtruesit e kërkesës, brenda një afati të caktuar dhe pa u dhënë mundësinë që të deklarohen lidhur me statusin juridik të avokatit E.G., sipas përcaktimeve të ligjit të aplikueshëm.

**Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata theksoi se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e së drejtës për “qasje në gjykatë” ishin të bazuara, për shkak se Gjykata Supreme, bazuar në garantitë kushtetuese por edhe vet Ligjin për Procedurën Kontestimore, para hedhjes poshtë të revizionit në mënyrë krejtësisht formale, duhet t’u kishte dhënë mundësi parashtruesve të kërkesës që të sqarohen lidhur me çështjen e përfaqësimit të tyre nga avokati E.G., ose të jepej mundësia që avokati E.G., të sjellë brenda një afati të caktuar dëshminë e përfaqësimit të parashtruesve të kërkesës.

**Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në kundërshtim me garantitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

**Referenca:** [KI182/20](#)

*b. Mospagesa e taksës gjyqësore*

[KI224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020

**Parimi:**

Refuzimi i ankesës të parashtruesit të kërkesës të paraqitur në vitin 2019 pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, për caktimin e masës së përkohshme ndaj pronës së caktuar për të ndaluar shitjen, tjetërsimin dhe mbindërtimin, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paguar taksën gjyqësore rezultoi në shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë.

**Faktet:**

Në vitin 2017, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS) për lëshimin e urdhrin paraprak gjyqësor, përkatësisht masës së përkohshme në lidhje me një pronë të tij. Dhomat e Posaçme kishin refuzuar një kërkesë të tillë me arsyetimin se kërkesa e parashtruesit kishte kuptim vetëm nëse i njëjti së pari ngritë padinë përkatëse, duke e shoqëruar padinë me kërkesë për masë të përkohshme. Parashtruesi i kërkesës nuk pranoi me kohë vendimin e kolegjeve të DHPGJS si shkas i papërgjegjësive së postës së gjykatës në fjalë. Kësisoj, parashtruesi i kërkesës kërkoi rivendosjen e së drejtës së tij për paraqitjen e padisë, pasi që afati në fjalë kishte kaluar pa fajin e tij. Ankesën e këtij të fundit, Kolegji i Apelit i DHPGJS e refuzoi duke e konsideruar si të tërhequr me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paguar taksën gjyqësore përkundër faktit se ky i fundit e kishte bërë veprimin e tillë.

**Pretendimet:**

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se instancat e DHPGJS-së, me vendimet e tyre, kishin shkelur, ndër tjera, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse vendimi i parë i DHPGJS-së, nuk kishte mbërritur tek ai për shkak papërgjegjësive së postës dhe nga po i njëjti autoritet nuk kishte shqyrtuar asnjëherë parashtresat e tij që konsistonin në vendimin për ndihmë juridike falas dhe kërkesën për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata konstatoi se barra e përgjegjësisë për mosadministrimin e parashtrësve të parashtruesit të kërkesës i takon autoritetit publik, përkatësisht Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, sepse parashtruesi i kërkesës ka bërë çdo veprim që i është kërkuar me dispozitat ligjore në fuqi, për t'u siguruar se ankesa e tij e ushtruar kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, do të shqyrtohej në merita.

### **Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS- së me të cilin është konsideruar e tërhequr ankesa e parashtruesit të kërkesës, nuk ka respektuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se në rastin konkret ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

**Referenca:** [KI224/19](#)

## 4. Mosshqyrtimi i akteve administrative individuale të autoriteteve publike

[KI214/21](#), parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022

### **Parimi:**

Refuzimi për shqyrtimin e padisë së parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me vlerësimin e dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës nga Gjykata Themelore, e Apelit dhe ajo Supreme, cenoi të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në drejtësi.

### **Faktet:**

Parashtruesi i kërkesës u lirua nga detyra e Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Republikën e Sllovenisë, nëpërmjet dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës. Kundër këtij dekreti, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë. Kjo e fundit hodhi poshtë si të palejuar padinë, me arsyetimin se dekreti i Presidentes nuk mund të jetë objekt vlerësimi në procedurën e konfliktit administrativ, dhe se i njëjti mund t'i nënshtrohet vetëm procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i tillë i Gjykatës Themelore, u konfirmua nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme.

### **Pretendimet:**

Parashtruesi i kërkesës pretendon që atij i është mohuar e drejta për të pasur mbrojtje efektive gjyqësore ndaj akteve të autoriteteve publike, gjegjësisht ndaj dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës.

### **Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata konstatoi se dekreti i kontestuar i Presidentes së Republikës së Kosovës për lirimin nga pozita të parashtruesit të kërkesës, ngërthente të “drejta civile” të parashtruesit të kërkesës dhe “kontest” apo “mosmarrëveshje” në kuptim të së drejtës për gjykimin të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, dhe për pasojë, duke u bazuar në dispozitat Kushtetuese dhe legjisllacionin e aplikueshëm, i takon grupit të dekretive të karakterit individual, të cilat mund të kontestohen në gjykatat e rregullta.

**Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, janë nxjerrë në shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

**Referenca:** [KI214/21](#)

**KI10/22**, parashtrues *Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 17 korrikut 2022

**Parimi:**

Refuzimi i gjykatave të rregullta për të shqyrtuar ligjshmërinë e akteve nën-ligjore, paraqet cenim të së drejtës për qasje në gjykatë për arsye se shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve nën-ligjore nga gjykatat e rregullta është detyrim ligjor dhe kushtetues i këtyre të fundit.

**Faktet:**

Rrethanat e rastit kanë të bëjnë me kontestimin e ligjshmërisë së Rregullores MD-Nr. 01/2020 të Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore, e cila rregullon organizimin dhe sistematizimin e këtij institucioni, duke argumentuar se ishte në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, veçanërisht nenin 15 (Veprimtaria e Institutit) të tij që përcakton veprimtarinë e Institutit. Rregullorja ishte miratuar nga Ministria e Drejtësisë dhe ishte publikuar në Gazetën Zyrtare më 3 janar 2021. Pavarësisht kërkesave nga Zyra Ligjore e Kryeministrit për ndryshimin e rregullores, Ministria e Drejtësisë nuk ndërmori veprime. Si rezultat, Sindikata paraqiti padi për vlerësimin e ligjshmërisë së rregullores në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Megjithatë, Gjykata hodhi poshtë padinë, duke argumentuar se rregullorja nuk ishte akt përfundimtar në procedurën administrative, ndaj të cilit mund të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së tij në procedurë gjyqësore. Vendimi i Gjykatës Themelore u vërtetua edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

**Pretendimet:**

Parashtruesit e kërkesës kontestuan vendimet e Gjykatës Supreme duke pretenduar se refuzimi i shqyrtimit të ligjshmërisë së Rregullores së lartcekur ka rezultuar në dështimin e gjykatave për të përmbushur detyrën e tyre kushtetuese. Ata argumentojnë se kjo sjellje ka shkelur të drejtat e garantuara nga Kushtetuta, duke përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe të drejtën për mjete juridike dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave. Avokati i Popullit, në shkresat e tij, gjithashtu theksoi rëndësinë e qartësisë të kompetencave të gjykatave për vlerësimin e akteve nënligjore dhe mbështeti qëndrimin se gjykatat e rregullta kanë autoritetin të shqyrtojnë ligjshmërinë e akteve të tilla sipas ligjeve të aplikueshme.

**Vlerësimi i Gjykatës:**

Gjykata vlerësoi se refuzimi i gjykatave të rregullta për të shqyrtuar ligjshmërinë e Rregullores së kontestuar ka cenuar të drejtën e parashtruesit për “qasje në gjykatë”. Ajo theksoi se ky detyrim buron nga Kushtetuta dhe është gjithashtu i përcaktuar në Ligjin 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Gjykata argumentoi se është obligim i gjykatave të sigurojnë supremacinë e ligjeve dhe të vlerësojnë përputhshmërinë e akteve nënligjore me ligjin e aplikueshëm, përfshirë Ligjin për Mjekësinë Ligjore. Duke refuzuar të shqyrtojnë këtë

rast, gjykatat i mohuan parashtruesit të drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, duke shkelur kështu garancitë e përcaktuara në nenet përkatëse të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

**Përfundimi:**

Gjykata konstatoi se në rastin konkret ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, dhe njëkohësisht konstatoi se vendimet gjyqësore të Gjykatës Supreme, të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore, duhet të shpallen të pavlefshme dhe çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën Themelore.

**Referenca:** [KI10/22](#)

## Lista e rasteve

### Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

#### Aktgjykimet

[Zubac kundër Kroacisë](#), [DhM] nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018

[Jones dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 34356/06 dhe 40528/06, Aktgjykim i 14 janarit 2014

[Naït-Liman kundër Zvicrës](#), nr. 51537/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018

[Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002

[Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 35763/97, Aktgjykimi i 21 nëntorit 2001

[Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës](#), nr.38366/97 dhe nëntë të tjera, Aktgjykim i 25 janarit 2000

[Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 4451/70, Aktgjykim i 21 shkurtit 1975

### Gjykata Kushtetuese

#### Aktgjykimet

[KI43/24](#), parashtrues *Merita Visoka, Eroll Visoka dhe Melinda Visoka*, Aktgjykim, i 24 shtatorit 2024

[KI84/22](#), parashtruese *Slavica Đorđević*, Aktgjykim i 11 shtatorit 2024

[KI49/23](#), parashtrues *Shaban Dulahu dhe të tjerët*, Aktgjykim i 11 shtatorit 2024

[KI04/23](#), parashtrues *Avdyl Bajgora*, Aktgjykim i 30 majit 2024

[KI172/23](#), parashtruese *Rejhane Ceka, Fiknete Ceka, Lejlane Ceka dhe Sara Ceka*, Aktgjykim i 30 majit 2024

[KI199/22](#), parashtrues *P.T.P. "Arta XH"*, Aktgjykim i 30 majit 2024

[KI38/23](#), parashtrues *Flamur Dylhasi*, Aktgjykim i 28 marsit 2024

[KI121/22](#), parashtrues *Mexhid Asllani, Ekrem Asllani dhe Nuredin Xhaferi*, Aktgjykim i 21 marsit 2024

[KI214/21](#), parashtrues *Avni Kastrati*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2022

[KI10/22](#), parashtrues *Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore*, Aktgjykim i 17 korrikut 2022

[KI55/21](#), parashtrues *Muhamet Ademi*, Aktgjykim i 10 marsit 2022

[KI182/20](#), parashtrues *Sedat Kovaçi, Servet Ergin, Ilirjana Kovaçi dhe Sabrije Zhubi*, Aktgjykim i 20 janarit 2022

[KI54/21](#), parashtrues *Kamber Hoxha*, Aktgjykim i 4 nëntorit 2021

[KI20/21](#), parashtruese *Violeta Todorović*, Aktgjykim i 13 prillit 2021

[K224/19](#), parashtrues *Islam Krasniqi*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020

[K80/19](#), parashtrues *Radomir Dimitrijević*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2020

[KI 62/17](#), parashtruese *Emine Simnica*, Aktgjykimi i 29 maj 2018

#### Aktvendime për papranueshmëri

[KI96/22](#), parashtrues *Naser Husaj dhe Ulis Husaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2023

[KI147/20, KI148/20, KI149/20, KI150/20, KI151/20 dhe KI152/20](#), parashtrues *Nezir Neziri dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, 1 janarit 2021

[KI78/18](#), parashtrues *Pashk Malota*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 shkurtit 2019

[KI62/18](#), parashtrues *Nadlije Gojani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 shtatorit 2018

[KI79/17](#), parashtruese *Vahide Badivuku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 janarit 2018